



---

## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më  
30.09.2016, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Dardan Sejdiu, nënkryetar, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Flamur Shala (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahim (LDK), Besa Rafuna (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik (PF), Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik (GIS).

**Munguan:** Sokol Krasniqi (LDK), Blerand Stavileci (PDK), Shaip Shabani (PDK), Lirijeta Rexhepi - Leci (PDK), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Abit Kastrati dhe Cuneyd Ustaibo (KDTP).

**Të pranishëm** ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues, duke e hedhur në votim rendin e ditës.

**Kryesuesi konstatoi se me shumicë votash, 30 (tridhjetë) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Flamur Shala, Imer Rusinovci, Muhamet Nura) dhe 4 (katër) abstenime, (Fadil Gashi, Besa Rafuna, Halim Halimi, Laura Zherka), u miratua ky**

## **R e n d i d i t ë s:**

1. Propozimvendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm "Kalabria" në Prishtinë;
2. Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes "Kodra e Trimave 1" në Prishtinë;
3. Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes "Mati 2" në Prishtinë;
4. Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm "Sofalia" në Prishtinë 2016-2024;
5. Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: "B 17", "B 18", "B 19", dhe "B 20", të lagjes "Mati 1" në Prishtinë 2016-2024;
6. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit, 01 nr. 031-124287, dt. 23.05.2016, për miratimin përfundimtar të kërkesës së grupit të qytetarëve të lagjes "Prishtina e Re"- Zona Perëndim;
7. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit, 01 nr. 031-52761, dt. 04.03.2016, për dhënien e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F - F" ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2" në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë;
8. Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

### **Pika e parë**

**Propozimvendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm "Kalabria" në Prishtinë.**

Lidhur me këtë propozimvendim diskutuan: Shpend Ahmeti, kryetar, Lirak Çelaj, Agim Gashi, Qëndron Kastrati, Muhamet Selmani, Mirlinda Sopi, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Dardan Sejdiu, nënkryetar, Flamur Shala, Ylli Hoxha dhe Shefki Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se me 24 (njëzet e katër) vota për, 12 (dymbëdhjetë) abstenime (Agim Gashi, Besa Rafuna, Fisnik Osmani, Hasime Krasniqi, Laura Zherka, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Naime Osmani, Shiqeri Spahiu, Vlora Dumoshi, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi), u miratua Vendimi për lënie në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm "Kalabria" në Prishtinë.**

#### **Pika e dytë**

**Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e Trimave 1” në Prishtinë.**

**Kryesuesi konstatoi se me 26 (njëzet e gjashtë) vota për, 4 (katër) vota kundër, (Besa Rafuna, Imer Rusinovci, Muhamet Nura, Shiqeri Spahiu) dhe 10 (dhjetë) abstenime, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Laura Zherka, Merita Surkishi, Mustafë Krasniqi, Vlora Dumoshi, Hazir Borovci, Lirak Çelaj), u miratua Vendimi për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Kodra e Trimave 1” në Prishtinë.**

#### **Pika e tretë**

**Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Mati 2” në Prishtinë.**

**Kryesuesi konstatoi se me 28 (njëzet e tetë) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Besa Rafuna, Muhamet Nura, Shiqeri Spahiu) dhe 8 (tetë) abstenime, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Laura Zherka, Merita Surkishi, Mustafë Krasniqi, Vlora Dumoshi), u miratua Vendimi për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm të lagjes “Mati 2” në Prishtinë.**

#### **Pika e katërt**

**Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm “Sofalia” në Prishtinë 2016-2024.**

**Kryesuesi konstatoi se me 24 (njëzet e katër) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Besa Rafuna, Muhamet Nura, Shiqeri Spahiu) dhe 11 (njëmbëdhjetë) abstenime, ( Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Halim Halimi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Vlora Dumoshi, Imer Rusinovci), u miratua Vendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm “Sofalia” në Prishtinë 2016-2024.**

#### **Pika e pestë**

**Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: “B 17”, “B 18”, “B 19” dhe “B 20”, të lagjes “Mati 1” në Prishtinë 2016- 2024.**

Lidhur me këtë propozimvendim diskutuan: Shpend Ahmeti, kryetar, Agim Gashi, Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj, Mirlinda Sopi, Imer Rusinovci, Feti Mehdiu, Visar Arifaj, Ylli Hoxha, Shiqeri Spahiu, Ardian Olluri, shef i Zyres ligjore, Muhamet Selmani, Remzi Pacolli, Shefki Gashi, Sadri Ramabaja, Shemsi Veseli, Dardan Sejdiu, nënkryetar, dhe Laura Zherka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 20 (njëzet) vota për, 14 (katërmbëdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Besa Rafuna, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Shiqeri Spahiu, Vjollca Dibra - Ibrahim, Vlora Dumoshi) dhe 2 (dy) abstenime, (Shaip Hajrizi, Laura Zherka), u miratua Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për blloqet: "B 17", "B 18", "B 19" dhe "B 20", të lagjes "Mati 1" në Prishtinë 2016- 2024.

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për anulimin e Vendimit, 01 nr. 031-124287, dt. 23.05.2016, për miratimin përfundimtar të kërkesës së grupit të qytetarëve të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Perëndim.**

Lidhur me këtë propozimvendim diskutuan Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore dhe Muhamet Selmani, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 28 (njëzet e tetë) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Muhamet Nura, Shiqeri Spahiu) dhe 2 (dy) abstenime, (Lirak Çelaj, Laura Zherka), u miratua Vendimi për anulimin e Vendimit, 01 nr. 031-124287, dt. 23.05.2016, për miratimin përfundimtar të kërkesës së grupit të qytetarëve të lagjes "Prishtina e Re" - Zona Perëndim.

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për anulimin e Vendimit 01, nr. 031-52761, dt.04.03.2016, për dhënien e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F - F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2" në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë.**

Për këtë propozimvendim diskutuan: Muhamet Selmani, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Shpend Ahmeti, kryetar, Lirak Çelaj, Qëndron Kastrati, Shiqeri Spahiu dhe Agim Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi konstatoi se me 2 (dy) vota për, 22 (njëzet e dy) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Bardha Dida - Rogova, Besa Rafuna, Fadil Gashi, Fisnik Osmani, Hasime Krasniqi, Kimet Zeqa, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Merita Surkishi, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Remzi Pacolli, Rita Begolli, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shiqeri Spahiu, Vjollca Dibra - Ibrahim, Vlora Dumoshi) dhe 10 (dhjetë) abstenime, (Genc Sherifi, Hatixhe Latifi - Pupovci, Kreshnik Ahmeti, Mirlinda Sopi, Sadri Ramabaja, Sofije Bunjaku, Teuta Krasniqi, Visar Arifaj, Ylli Hoxha, Halim Halimi), nuk u anulua Vendimit 01, nr. 031-52761, dt. 04.03.2016, për dhënien e pëlqimit për ndryshimin - përshtatjen e profilit të rrugës "F - F", ndërmjet blloqeve "B 1" dhe "B 2" në lagjen "Lakërishta" në Prishtinë.

## **Pika e tetë**

### **Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve.**

Lidhur me Informatën për menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve, diskutuan: Gent Begolli, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Agim Gashi, Bardha Dida – Rogova, Vjollca Dibra – Ibrahimimi dhe Sofije Bunjaku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

### **Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve.**

## **Pika e nëntë**

### **Pyetje dhe përgjigje**

#### **Imer Rusinovci, pyetje për Drejtorinë e Urbanizmit.**

Është një kërkesë e shkollës "Don Bosko", ku si çështje problematike paraqitet një aneks i shkollës. Aty ka filluar ndërtimi i një aneksi, por për të vazhduar ka pengesa. Këtë shqetësim e ka prezantuar edhe drejtori i kësaj shkolle, andaj e vlerësoj të arsyeshme që këtë çështje ta trajtojmë në Kuvend.

**Mirlinda Sopi** ngriti shqetësimin rreth punës së komisionit për emërtimin e rrugëve. Ajo kërkoi një përgjigje nga Zyra ligjore ose Kuvendi, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje për rishikimin e këtyre listave të emërimit të rrugëve, pasi që kemi ankesa të vazhdueshme nga qytetarët. Konkretisht, është fjala për kërkesën e familjes Pacolli, e cila kërkon revokimin e emërimit të rrugës "Isa Pacolli", në lagjen "Hajvalia" të Prishtinës.

**Lirie Avdiu** theksoi se për emërtimin e rrugëve për zonat rurale, më konkretisht Hajvalia dhe të tjerat, propozimet kanë ardhur nga kryetarët e bashkësive lokale, në koordinim me banorët e fshatit, atje nuk kanë qenë propozimet e anëtarëve të komisionit, por të kryetarëve të bashkësive lokale.

#### **Kreshnik Ahmeti, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Pronës.**

Ka më shumë se disa muaj që AKP-ja është duke qëndruar në objekt, edhe pse kontrata për vazhdimin e qëndrimit ka skaduar para 3-4 muajve.

-Pse është vonuar deri tash intervenimi i inspektoratit, apo i kujtdo qoftë tjetër, në atë hapësirë, dhe çka po ndodh, a ka ndonjë marrëveshje tjetër dhe a do të silllet në Kuvend? Për këto pyetje kërkoj përgjigje me shkrim.

**Bardha Dida - Rogova, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.**

- Kur do të rregullohet shtegu i këmbësorëve pranë çerdhes "Dielli" në lagjen "Kodra e Diellit", përkatësisht rruga që lidhë rrugën "Enver Maloku" me Banesat e kaltra?
- Kur do të bëhet ndriçimi i lagjes "Kodra e Diellit", te Banesat e kaltra, gjegjësisht afër çerdhes "Dielli"?
- Kur do ta kemi një raport mbi menaxhimin e qendrave sociale në komunën e Prishtinës, procedurat për birësimin e fëmijëve dhe familjet kujdestare, gjendjen e tyre ekonomike dhe detajet tjera rreth tyre?

**Laura Zherka, pyetje për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit.**

- Cilat janë kriteret për pranimin e fëmijëve në çerdhe, konkretisht, është fjala për çerdhen "Ardhmëria" në lagjen "Kodra e Diellit", ku aty pranohet fëmija i lagjes tjetër me kriteret të njëjta, e nuk pranohet fëmija që është komshiu i parë i asaj lagjeje?

**Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, për pyetjen e parashtruar nga znj. Zherka dha sqarime të nevojshme.**

**Hatixhe Latifi - Pupovci, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.**

- A ka ndonjë planifikim për shkallët në lagjen "Arbëria", kur do të rregullohen ato?

**Lirie Avdiu, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit.**

- Banorët e Lagjes së Muhaxhirëve përreth Parkut të qytetit, kërkojnë që të merren masa për evitimin e një dukurie, ku drurët e parkut janë shndërruar në një vend ku bëhet grumbullim i shpezëve të llojit korbë edhe sorrë?  
Ky numër kaq i madh i shpezëve përveç që shkakton probleme të zhurmës, kundërmon edhe erë shumë të keqe. Për shkak të kësaj problematike, parku më nuk po frekuentohet për ecje.

**Shemsi Veseli, kërkesë për Kryetarin e Komunës.**

Kërkoj nga Kryetari i Komunës që ta iniciojë procedurën për kthim në rishqyrtim të vendimit për dhënien e lejes për Spitalit Amerikan, pasi që nuk janë përmbushur obligimet e parapara sipas kontratës nga palët që e kanë marrë në shfrytëzim.

Lidhur me pyetjet e parashtrua nga Bardha Dida - Rogova, Hatixhe Latifi - Pupovci dhe Lirie Avdiu, **Gent Begolli**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dha sqarime të nevojshme.

**Pika e dhjetë**  
**Të ndryshme**

**Remzi Pacolli**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit për emërtimin e rrugëve, theksoi se komisioni për emërtimin e rrugëve ka qenë në nivelin e duhur. Defektet kanë qenë në sistem, sepse komisioni nuk ka bërë asnjë ndërrim të emërtimit të rrugëve. Neve si komision na kanë ardhur vetëm listat me kodet e rrugëve, listat e zbrazëta për rrugët e paemërtuara, dhe në ato kode kemi vendosur emra që na janë prezantuar.

**Merita Surkishi** përkrahu mendimin që listat e emërtimeve të rrugëve të rishikohen edhe një herë, sepse ka pasur ankesa prej qytetarëve që janë hequr emra, e që nuk kanë pasur të drejtë të hiqen.

**Qëndron Kastrati** ngriti një çështje lidhur me tensionet që po krijohen në mbledhjet e Kuvend të Komunës, në raport me pretendimin për moskorrektësinë e kryesuesit për dhënien e fjalës anëtarëve të Kuvendit për diskutim. Lidhur me këtë ceku se, ka gjasa dhe ka mundësi që për shkak të shumë angazhimeve njëkohësisht, ose në cilën anë është i drejtuar kryesuesi, mund të ketë moskorrektësi në raport me dhënien e fjalës, andaj kërkoj që dikush nga Zyra e Kuvendit të asistojë aty, ta bëjë një listë dhe vetëm ta përcjellim listën, sepse po shihet se tensionet gjithmonë janë në rritje.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:00.*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**